



# Permbledhje joteknike e aktiviteteve

## *“Trajtimi dhe perpunimi i qumeshtit”*



**Subjekti:** “Delta Doni” sh.p.k.

**Hartoi:** “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

**Administrator:** Shkelzen MADANI



Tirane, 2022



## **PERMBAJTJA**

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedisore te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisore te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



## 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

### ➤ Profili i propozuesit

Personi fizik subjektit “Delta Doni” Sh.p.k. ushtron aktivitetine tij “Trajtim dhe perpunim qumshti” me vendndodhjen ne Fshati Gorre, Komuna kolonje, rrethi Lushnje, Qarku Fier. Siperfaqja e sheshit eshte 4000m<sup>2</sup> dhe i ndertimit eshte 840 m<sup>2</sup> dhe me kapacitet 5-6 ton/ditë.



### ✚ PERSHKRIMI I SUBJEKTIT

Proçesi i punës gjate zhvillimit te aktivitetit "Trajtim dhe perpunim qumshti" te subjektit “Delta Doni” Sh.p.k, fillon me pranimin e lendes se pare qe eshte qumeshti i cili mblidhet ne ferma te ndryshme dhe ku me pas ne fabrike fillon procesi i pasterizimit, analizimi i parametrave dhe prodhimi i nenprodukteve te qumeshtit. Pasterizimi behet ne nje temperature 75°C. E me nje skremim ne baze te produktit te prodhuar 0.5%, 1.5%, 3.5% yndyre.

Më konkretisht, këtu përfshihen:

- Homogjenizimi
- Paketimi
- Kontrolli i cilesise dhe hedhje ne treg e qumeshtit dhe nenprodukteve te tij

Në laboratorin e brendshëm te subjektit “Delta Doni” Sh.p.k kryen te gjitha analizat e lendes se pare dhe produktit te gatshem sipas standartit European. Laboratori kryen kontroll te vazhdueshëm, parandalues, në çdo fazë të ciklit të prodhimit:

- Lënda e pare; duke filluar nga çasti kur qumeshti vjen ne fabrike
- Produkte në proçes; në momente të ndryshme të proçesit teknologjik
- Ambienti: si brenda ashtu dhe jashtë (temperatura, lagështia, ajrosja, etj.)
- Produkti i gatshëm; Qumeshti dhe nenproduktet e tij.

Analizat që kryhen në këtë laborator mund të klasifikohen në dy grupe kryesore:

1. Në grupin e Parë të analizave fiziko-kimike, përfshihen analizat, që kryhen mbi lëndën e parë (qumesht).

Këtu bëjnë pjesë analizat e përmbajtjes së proteinës, yndyrës.

2. Grupi i dytë i analizave mikrobiologjike konsiston në kontrollin për infeksione dhe parandalimin e tyre.



Ky kontroll bëhet në tre linja:

- Mjediset e fabrikes
- Tanket e qumeshtit
- Analizat e drejtpërdrejta në qumesht

Këto kontrolle kanë karakter parandalues të mikrobeve që mund të futen dhe të dalin nga fabrika.

Gjatë realizimit të procesit të prodhimit të qumeshtit, në mënyrë paralele, me orare të caktuara, kryhet mbledhja e qumeshtit, në qendrën e grumbullimit. Qumeshti transportohet në qendrën grumbulluese, nëpërmjet një sistemi plotësisht automatik.. Ky sistem kontrollon drejtpërdrejt nga departamenti i grumbullimit.

Pas grumbullimit, sipas kategorive të përcaktuara në standard , qumeshti ambalazhohet, etiketohet dhe magazinohet. Më pas, qumeshti kalon në procesin e shitjes. Transporti kryhet me mjetet e firmes deri në destinacionin final në kushte frigoriferike në temperaturën 4-6 °C. Është kërkesë e firmes që po kështu të ruhet nga konsumatori.



Në fabriken **“Delta Doni” Sh.p.k** përpunohet qumesht i grumbulluar nga fermerat dhe trajtohet nëpërmjet një teknologjie bashkohore dhe moderne. I gjithë procesi nga marrja e qumeshtit deri në paketim kryhet me cikël të mbyllur. Makineria e paketimit të qumeshtit realizon larjen, mbushjen, mbylljen e tapave, etiketimin, datën e skadimit dhe paketimin me koli në mënyrë automatike.



Pasterizatori është i kompletuar me sistem automatik sipas kërkesave të BE, realizon pasterizimin e qumështit sipas kërkesave të teknologjisë së produktit.

Makineria e paketimit të kosit me gota realizon mbushjen, mbylljen me kapak, datën e skadimit dhe vendosjen në arka në mënyrë automatike.

Homogjenizatori siguron shpërndarjen e yndyrës në mënyrë uniforme në të gjithë qumështin. Përsa i përket higjenes në fabrike sigurohet çdo ditë larja me solucione lares-dizinfektues të garantuar dhe shumë efektive.

## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

### **Gjeologjia e rajonit**

Në këtë rajon kemi të bejmë me tokat e hirta dhe të kafta, këto toka janë formuar mbi shkëmbinj argjilor të neogjenit. Kane profile të diferencuara me ngjyrë të hirtë të kuqerremte, perberje mekanike subargjilore të mesme në të rënde. Perberja kimike e tyre tregon se janë mestarisht të pasura me humus. Përsa i përket elementeve ushqyese të asimilueshme nga bimët këto toka paraqiten të varfëra me azot dhe fosfor dhe të pasura në patos. Kuota ku është ngritur ky aktivitet është me një ngritje të vogël nga toka bujqësore e cila lejon që të kemi vetrjedhje të ujërave të bardha dhe të reshjeve. Nga ana gjeologjike në bazamentin në bazamentin ku është ndërtuar ky aktivitet ka të bëjë me formacionin kuaternar Q<sub>4</sub>AL. Formacioni argjilor nuk lejon që ujërat sipërfaqësore të reshjeve si dhe uejrat e ndotura të futen në thellësi, por ato për shkak të kuotes së lartë dhe kanaleve kullues drejtohen drejt kanalit kryesor ku para se të shkojnë në kuotën me të ulet ka një gropë dekantimi.

### **Klima**

Fieri është si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe dimër i butë dhe me rreshje të mëdha. Ngricat dhe dëborat janë dukuri tepër të rralla. I nxehti fillon që prej mesit të pranverës dhe vazhdon deri në fund të tetorit. Klima e Fierit është e ngrohtë sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave të ftohta. Fieri dallohet për numrin e lartë të ditëve me diell, mesatarisht 2800 ore në vit. Rreshjet kanë rregjim kohor shumë të çrregullt ato janë përqendruar kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000 mm/vit. Vera në Fier është e thatë dhe shpesh nuk bie shi për javë të tëra. Muajt më të lagesht janë nëntori dhe janari, kurse muajt më të thatë korriku dhe gushti. Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën që klima të jetë e butë dhe vetëm në raste tepër të rralla temperaturat të bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 15°C-16°C. Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqësie shumë degëshe. Gjithashtu toka bujqësore mund të shfrytëzohen 2-3 herë në vit. Zona ku do zhvillohet aktiviteti ka klimë mesdhetare fushore. Temperatura mesatare me e lartë është në muajin korrik, gusht 23 °C, dhe me e ulet në muajin Janar 7.2 °C. Ndryshimi i lageshtisë relative të ajrit gjatë vitit është i lidhur ngushtë me ecurinë e temperaturës së ajrit. Vlerat me të larta të lageshtisë janë në



periudhen e ftohte te vitit ndersa me te uleta ne periudhen e ngrohte te tij. Per arsye se jemi prane zones fushore dhe ne afersi te detit mbizoterojne erera nga kuadrati i perendimit dhe veri perendimit. Ne dimer mbizoterojne erera te lindjes dhe te jugut.

### **Trashegimia arkitektonike**

Aktiviteti qe kryhet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte te trasheguara dhe te ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse ne kete zone ato nuk ekzistojne. Eshte per t'u theksuar se ne kete zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonumente.

### **Flora dhe fauna**

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë zona dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinsh. Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Zona bën pjese ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati I makies, ku rriten shkurret me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel

### **Pasurite ujore**

Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi të veçantë kanë pasuritë ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi përshkohet nga lumenjtë Seman, Vjosë e Gjanica. Semani - 281 km i gjatë formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin në afërsi të Beratit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5949 km<sup>2</sup>, prurja mesatare vjetore e tij arrin në 96 m<sup>3</sup>/sek. Semani është ndër lumenjtë më eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjosa - 272 km i gjatë buron nga malet e Pindit në Greqi. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 6700 km<sup>2</sup>, ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m<sup>3</sup>/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Poçemit e të Kalivaçit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 234 km<sup>2</sup>. Është një nga lumenjtë më të ndotur në vend, për shkak të derdhjes së naftës. Rrethi ka edhe disa liqene artificiale ku më i madhi e më i rëndësishmi prej tyre është ai i Kurjanit me sipërfaqe 375 ha, ujërat e tij përdoren për ujitje.

## **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Nje nga objektivat eshte edhe identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen gjate fazes se funksionimit te aktivitetit.

### **o Ndikimet ne popullsi**

Realizimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet aktiviteti. Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk ka emetime ne ajer, toke



apo uje te cilat ndotin ambjentin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsise se rajonit. Ne zhvillimin e aktivitetit nuk jane parashikuar ndryshime ne popullsine e zones, te zhvendosjes se saj, per shkak te tij. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne shendetin fizike dhe mendor te popullsise dhe te gjitha keto per arsye se aktiviteti zhvillohet ne ambjent te mbyllur, brenda fabrikes.

#### ○ **Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin**

Aktiviteti nuk do ndikojte absolutisht ne rruget lokale dhe transport, perkundrazi subjekti eshte angazhuar te mirembaje rruget lokale te transportit me qellim te mbarvajtjes se mire te aktivitetit te tij.

#### ○ **Ndikimet ne toke**

Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta qe te demtojne mjedisin. Ne proceset e trajtimit te ujerave, nga procesi i filtrimit e dekantimit mund te krijohen sasira minimale te mbetjeve te ngurta por qe jane te paperfillshme.

#### ○ **Ndikimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit qe zhvillohet nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere. Emetimet ne ajer do te vijne nga pluhurat qe krijohen gjate proceseve te punes por ambientet e punes do te jene te pajisura me filtra per kapjen e tyre keshtu qe nuk do te kete ndikime negative. Gjithashtu jane marre masa per ajrosje dhe ventilim te ambienteve te punes, pra mund te themi se emetimet ne ajer jane ne nivele te paperfillshme.

#### ○ **Ndikimet ne ujera**

Nuk do te kete ndikime ne ujera dhe as ndotje sepse proceset zhvillohen brenda territorit te fabrikes dhe asgje nuk del jashte saj. Per pasoje nuk do te kete ndotje te ujerave. Ujerat qe dalin nga proceset e perpunimit te qumeshtit, shkojne ne gropa dekantuese. Aty ato trajtohen me reagent kimik ne menyre qe parametrat e tyre te jene brenda normave dhe me pas ato perdoren per pastrimin e territorit te fabrikes.

#### **Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

#### ○ **Ndikimet ne flore dhe faune**

Aktiviteti do te zhvillohet ne nje ambient te mbyllur keshtu qe nuk do te kete lidhje me mjedisin e jashtem, per rrjedhoje as derdhje te shkarkimeve apo mbeturinave qe mund te shkaktojne ndryshime ne floren dhe faunen e zones.

#### ○ **Ndikimet nga zhurmat**

Duke qene se fabrika punon vetem me energji elektrike nuk do te gjenerohen zhurma.





Zhurmat që do të emetohen vijne kryesisht nga ambientet e punës, ambalazhimi i shisheve të ujit mineral natyral dhe të gazuar. Këto zhurma do të mbahen në kontroll dhe do të jenë brenda normativave të lejuara për të mos patur ndikime negative në mjedisin përreth.

○ **Ndikimet e zhvillimit të aktivitetit mbi ndertimet, trashëgimë arkitektonike dhe historike**

Aktiviteti që ushtron shoqëria “Delta Doni” sh.p.k zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgimë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njerezore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar këto aktivitete, por njëkohësisht një zonë në të cilën aktiviteti nuk shoqërohet me pasoja ndotëse për mjedisin. Madje edhe zona përreth fabrikës është zonë bujqësore.

**MASAT PËR ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS**

Me qëllim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes së efekteve pozitive në mjedis, nga ana e shoqërisë do të sigurohet marrja e masave si më poshtë:

**Territori përreth fabrikës**

I gjithë territori i fabrikës dhe sheshet e levizjes janë të shtruar dhe të sistemuara. Nga shoqëria janë marrë masa edhe për gjelberimin e territorit përreth fabrikës duke bërë të mundur mbjelljen me pemë, gjithashtu nga stafi do tregohet kujdes për mbajtjen pastër të ambientit dhe pastrimin e mjedisit në ndonjë rast ndotjeje.

**Emetimet në ajër**

Shkarkimi i gazrave të makinave shpërndarëse të qumështit janë burimet e mundshme të ndotjes së ajrit, të cilat mund të rrisin përqendrimin e materialeve të imta në të. Pjesa më e madhe e mjeteve do të operojnë në një ambient të hapur, me një dispersion të madh, për shkak të rrymave dhe erërave. Gjithsesi, ndikimi në ndotjen e ajrit, mund të konsiderohet i paperfillshëm, për shkak të levizjes të ulet të makinave të shpërndarjes së mallit.

Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ketë çlirime të aromave të ndryshme në ambientet përreth objektit e as në brendësi të tij.

**Mbetjet e ngurta**

Gjatë periudhës së funksionimit, problemi i prodhimit të mbeturinave do të jetë i parëndësishëm, sepse do të prodhohen mbeturina tepër të vogla nga vetë proceset e punës. Pritet gjithashtu, prodhimi i mbeturinave personale të punëtorëve dhe personelit. Mbetjet që dalin nga aktiviteti seleksionohen sipas llojit të materialit me pas depozitohen në vende të caktuara brenda territorit të sheshit të fabrikës dhe mbetjet urbane të akumuluar depozitohen në koshat më të afërta të mbeturinave.

Masat mbrojtëse për mbetjet e ngurta janë:



Mbetjet e ngurta urbane qe nuk i ribashkohen procesit teknologjik, te largohen cdo dite nga vendgrumbullimi i tyre dhe te dergohen per ne vendgrumbullimet e percaktuara nga pushteti vendor.

Mbetjet dhe llumrat e dala nga procesi teknologjik te depozitohen perkohesisht ne mjedise te posacme, kazane metalike ose plastike, te cilat nuk bashkeveprojne me mbetjet dhe nuk lejojne derdhjet e tyre ne momentin e administrimit apo depozitimit ne vendin e percaktuar nga organet shteterore.

Te pastrohen menjehere rrjedhjet, derdhjet, pikimet, per te parandaluar ndotjen e tokes.

Mbetjet e ngurta urbane qe do te krijohen nga ambalazhimi i materialeve qe do te depozitohen ne magazine te riciklohen sa te jete e mundur dhe ato qe nuk mund te riciklohen te depozitohen ne pikat e caktuara nga Bashkia/Komuna.

### **Shkarkimet e ujerave**

Nuk do te kete ndikime ne ujera dhe as ndotje sepse proceset zhvillohen brenda territorit te fabrikes dhe asgje nuk del jashte saj. Per pasoje nuk do te kete ndotje te ujerave.

### **Zhurmat**

Zhurmat ne mjediset e punes jane brenda normes sanitare te lejuar, dhe per pasojë as zhurmat ne mjediset e jashtme nuk pritet te kenë ndikim ne popullaten perreth. Ky nivel zhurmash nuk ndikon ne shendetin e punonjesve te Subjekti dhe as ne shendetin e personave qe punojne ne ambientet perreth.

### **Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune**

#### **➤ Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziket ne pune dhe masat e menyrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si dhe unifromat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

#### **➤ Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.